



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.36/2025

Paneli Zgjedhor Për Ankesa Dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Hajriz Hoti-kryesues, Violeta Husaj Rugova dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së dispozitave të Kodit të Sjelljes për Subjektet Politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët, në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të cilat do të mbahen më 28 Dhjetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 26.12.2025, merr këtë,

VENDIM

Konstatohet se është tërhequr ankesës së parashtruar nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, ZP. A.nr.36/2025 e datës 24.12.2025, e paraqitur kundër Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së dispozitave të Kodit të Sjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të cilat do të mbahen më 28 Dhjetor 2025.

Arsyetim

PZAP-i, më datë 24.12.2025, ka pranuar ankesën nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, ZP. A.nr.36/2025, të paraqitur kundër Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së dispozitave të Kodit të Sjelljes për Subjektet Politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Më datë 24.12.2025, ankuesi ka parashtruar kërkesën me nr. Protokolli ZP. A.nr.36/2025 për tërheqjen e ankesës së lartcekur për arsye teknike procedurale.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi kërkesën për tërheqjen e ankesës, në kuptim të nenit 11 paragrafi 8 i Rregullores nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimi dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-së, si dhe nenit 115.1 të LZP -së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL.Anr.36/2025, datë 26.12.2025

Kryesues i Panelit

Hajriz Hoti

